

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"MIDHA" sh.p.k

Ne mbeshtetje te Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", sot me date 01 Qershor 2022 me vullnetin e lire e te plote:

- I. Z. Nikoll Kola, shtetas shqiptar, lindur me date 18.05.1965, ne Qelez, Puke, me banim ne Tirane, mbajtes i kartes identitetit me nr. 036087458 dhe numer personal G505180530, madhore dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.
- II. Z. Viktor Kola, shtetas shqiptar, lindur me date 25.08.1965, ne Midhe, Puke, me banim ne Tirane, mbajtes i kartes identitetit me nr. 035928958 dhe numer personal G50825122M, madhore dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.

vendosem te **krijojme dhe miratojme statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "MIDHA" sh.p.k**, me kete permabatje.

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Sot me date 01 Qershor 2022 ne, themeluesit, ne mbeshtetje te legjislacionit Shqiptar, kryesisht ne Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe akteve te tjera ligjore ne fuqi kemi perpiluar dhe nenshkruar statutin e shoqerise si me poshte vijon:

Neni 1

FORMA

- 1.1 Shoqeria "MIDHA" sh.p.k eshte një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, veprimtaria e se ciles do te rregullohet me ane te ketij Statuti dhe nga legjislacioni ne fuqi.
1.2 Ky statut eshte perpiluar ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter te detyrueshem per nenshkruesit e tij, ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne te, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

Shoqeria me perjegejsi te kufizuar "MIDHA" sh.p.k, krijohet nga ortaket e saj,

- I. Z. Nikoll Kola, shtetas shqiptar, lindur me date 18.05.1965, ne Qelez, Puke, me banim ne Tirane, mbajtes i kartes identitetit me nr. 036087458 dhe numer personal G505180530, madhore dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.
- II. Z. Viktor Kola, shtetas shqiptar, lindur me date 25.08.1965, ne Midhe, Puke, me banim ne Tirane, mbajtes i kartes identitetit me nr. 035928958 dhe numer personal G50825122M, madhore dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.

Neni 2

EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i shoqerise eshte "MIDHA" sh.p.k.

Neni 3

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria "MIDHA" sh.p.k e ka qendren ne adresen Puke, Fshati Midhe me numer pasurie 918 dhe kod unik 2687004167.

Neni 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria "MIDHA" sh.p.k do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj prane QKB, ne perputhje me afatin e kontrates se koncesionit te nenshkruar me Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes.

KREU II

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 5

Objekt veprimtarise se shoqerise "MIDHA" sh.p.k do te jete :

Import-Eksport te materialeve te ndryshme dhe Ndertim. Ndertimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve tek Autoriteti Kontraktues, Ministria e Ekonomise ku perfshihet financimi, projektimi, ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike. Te hartoje projektin e ndertimit te hidrocentraleve, te lidhe kontrata supermarrjeje per zbatimin e punimeve te projektit si dhe çdo lloj kontrate tjeter me qellim realizmin e objektit te kontrates se koncesionit. Shfrytezimin dhe Administrimin e Hidrocentraleve. Shitia e elektricitetit te prodhuar ne Shqiperi dhe jashte saj, blerje dhe shitje te pajisjeve per ndertim HEC-i (tubacione çeliku, turbina, shtylla betoni, te gjitha pajisjeve dhe aksesoreve te tjera qe sherbejne per ndertimin dhc futjen ne pune e hidrocentralit), brenda dhe jashte vendit.

Ne fushen e ndertimit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, supermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhere, dhe te gjitha veprave te tjera madhere, ujesellesve, Ujerave mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujitese, centralet, objektet turistike, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne per gjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe çdo ndertim tjeter i cili ne perfundim perben send te paluajtshem sipas Kodit Civil per shkak te truzezimit ne menyre te qendrueshme e te vazhdueshme me token ose ndertesen ku eshte vendosur.

Ne fushen e turizmit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, supermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktura te pjesave perberese te saj, per shfrytezimin njerezor me karakter pushues, argetues, edukues dhe/ose kurues, te burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative,

te Shqiperise dhe me gjere, per realizimin e hotelerise, fshatra turistike, qendra turistike e te tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve te nevojshem, si barbufë, restorante, qendra estetike, palestra fitnesi, njesi te shitjeve te konfeksiioneve dhe prodhimeve ushqimore e industrial e te tjera te kesaj natyre; Krijimin e agjencive turistike e te tjera.

Ne fushen e transportit, shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktureve dhe/ose te pjesave perberese te saj, per transportimin publik dhe/ose privat te njerezve dhe mallrave si dhe tranzitim e tyre per gjate territorit te Shqiperise nepermjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj. Shoqeria gjithashtu do te kryeje dhe duke mos u kufizuar vetem ne, aktivitetet e me poshtme: Sipermarrje dhe realizim i ndermjetesimit dhe transportit, ngarkimit dhe shkarkimit te mallrave me tren e automjete ne interes dhe per llogari te shoqerise dhe te Porositesve, persona te trete. Sipermarrje dhe realizimi i puneve te ndermjetesimit, agjencise dhe transportit ne interes te vete shoqerise ose te paleve te treta porositese.

Ne fushen e Energjisë aktivitetin e tregtimit me pakice te karburanteve, mbajtjen e depozitave te karburanteve per efekt te aktivitetit te shoqerise per tregtimin dhe per dorimin e karburanteve per shkak te veprimtarise se saj.

Qiradhenie, Bar-Restorant, Parkim, kend lojerash, qender argetimi per femije te te gjitha moshave, qender per zhvillim te lojerave sportive dhe jo sportive, zhvillim trajnimesh, kurse argetuese dhe edukative, sherbime pastrimi (perfshire edhe lavazh automjete).

Gjithashtu shoqeria do te mund te kryeje çdo aktivitet tjeter ekonomik, tregtar, financiar, qe gjykohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e objektit te shoqerise, perfshire shitjen e mjeteve te shoqerise si makinerite, pajisjet, marra dhe dhenia me qira, te qenit garant, hipotekimi dhe pjesemarrja ne shoqeri te tjera.

Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise.

Neni 6

Shoqeria ka te drejte te shtoje objektin e veprimtarise se saj me vendimin unanim te Ortakeve te saj.

Neni 7


Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe gezon te drejten per te hapur filiale ose dege dhe perfaqesi te tjera ne Shqiperi dhe jashtë saj ne perputheje me legjislacionin Shqiptar dhe te vendeve ku do te ushtroje veprimtarine.

Neni 8

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit. Per detyrimet e veta Shoqeria per gjigjet me pasurine e saj.

Neni 9

Ortaket qe marrin pjese ne kete shoqeri nuk jane per gjegjes per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, tej kapitalit themeltar te saj, qe vete ata kane nenshkuar, gjithashtu shoqeria nuk per gjigjet per detyrimet personale te ortakeve te saj. Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise se ortakeve.



KREU III

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 10

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise "MIDHA" sh.p.k perbehet nga para me nje vlera te barabarte me 100.000 (njeqind mijë) leke. Ky kapital perbehet nga 2 kuota me vlere nominale 50.000 leke secila dhe do te shlyhet nga ortaket ne proporcione pjeset e kapitalit qe ata zoterojne ne shoqeri, brenda 1 viti nga regjistrimi i shoqerise ne QKB.

Kapitali themeltar eshte i ndare sipas kontributeve si me poshte:

Ortaket

- 1.Z. Nikoll Kola 50 % (pesedhjete perqind) te kuotave, 1 kuote.
- 2.Z. Viktor Kola 50 % (pesedhjete perqind) te kuotave, 1 kuote.

Neni 11

RRITJA E KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te shtohet me vendim unanim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, vendim i cili duhet te depozitohet ne zyren perkatese.

Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithe ortaket kane te drejte te nenshkruajne rritjen ne report me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre. Ne rast se nje apo disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset qe i rezervohen atij/atyre ne rritjen e kapitalit mund te nenshkruhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre. Zmadhimi i kapitalit mund te behet me para, me ane te kontributeve ne natyre ose perfshirjen e rezervave (ncsc ka) dhe fitimit. Rritja e kapitalit do te behet me kuota te reja apo me rritjen e vleres se kuotave ekzistuese. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkruhen dhe vlera e tyre nominale do te paguhet plotesisht. Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufirin qe percakton ligji. Zvogelimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

Neni 12

TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

Kapitali themeltar ose pjesa te vecanta te tij, jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve te shoqerise. Transferimi i kapitalit apo pjesave te tij mund te transferohen ne favor te te treteve, me akt notarial te posaçem, me miratim te Autoritetit Kontraktues. Ne çdo rast ortaket kane te drejten e parablerjes se kuotave.

Nese nje nga ortaket, qe mund te shtohen me vone ne shoqeri deshiron te shese kuotat e tij ai duhet te respektoje te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te kesaj shoqerie.

Te gjitha veprimet e shoqerise qe kane te bejne me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar, qe te konsiderohen te vlefshme duhet te miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve me unanimitet.

Ne çdo rast vleresimi i kapitalit ne natyre qe zoteron apo do te krijoje shoqeria ne te ardhmen do te behet me vendim nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve ne baze te nje raporti te pergatitur nga nje ekspert kontabel i emeruar nga Asambleja.

Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- q) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate, perggjigen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas Nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 13

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj duke u bazuar ne kete Statut dhe ne ligjet ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Shoqeria kryen veprimtarine e vet me mjetet e saj financiare, me mjetet e kredi te akorduara ne menyre te ligjshme. Shoqeria gezon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka te drejte ti perdore ato ne perputhje me objektin dhe qellimin e veprimtarise se saj.

Neni 15

Kapitali themeltar i shoqerise dhe kapitali i mevonshme mund te krijoje nje fond te vecante qe mund te mbetet ne llogarine bankare te shoqerise. Fondet monetare te shoqerise do te perdoren ne perputhje me kete statut dhe ligjet ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Shoqeria do te celi llogari ne banke. Ajo do te mbaje llogarine duke u mbeshtetur ne lekun shqiptar, euro, usd e monedha te tjera te huaja. Veprimet bankare do te kryhen nga ana e ortakeve dhe administratorit te saj.

Neni 17

Shoqeria do te krijoje keto fonde: Fondi Themeltar, Fondi Rezerve, Fondi i Shperblimit. Per zhvillimin e veprimtarise se vet shoqeria mund te krijoje edhe fonde te tjera. Fondi themeltar i shoquerise formohet nga Kapitali Themeltar si dhe mjetet qe do te krijohen gjate aktivitetit ekonomik te saj.

Neni 18

Shoqeria shfrytezon fondin themeltar per ushtrimin e veprimtarise se vet per investime te ndryshme ne interes te realizimit te qellimit te shoquerise, si dhe per te mbuluar rreziqet mbas shfrytezimit te fondit rezeve. Fondin themeltare shoqeria mund ta shfrytezoje edhe per destinacione te tjera te veprimtarise se saj afariste.

Neni 19

Fondi rezerve i shoquerise formohet nga nje pjese e fitimit, qe ajo realizon gjate veprimtarise se saj, qe percaktohet me nje vendim te vecante te Ortakeve te saj. Fondi Rezerve shfrytezohet per te mbuluar humbjet dhe rreziqet.

KREU V

ORGANET DREJTUESE TE SHOQUERISE

Neni 20

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ORTAKEVE

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoquerise, qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te peraktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoquerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, vendos per çeshtje si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoquerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- q) percaktimin e shperblimeve;
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoquerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) shqyrtimin e transferimit te kuotave tek persona te trete jo ortake te shoquerise.
- g) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- h) ndryshimin e statutit, e selise se shoquerise, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj.
- i) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoquerise;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoquerise etj.



MENYRA E THIRRJES SE MBLEDHJEVE

21.1 Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per çeshtjet e shtruara perpara saj nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

21.2 Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga çdonjeri prej Ortakeve.

21.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne Shqiperi apo ne çdo qytet apo province te botes, siç bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithe Ortaket bien dakord.

21.4 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjeter ne perputhje me Nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

21.5 Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Rezoluta e propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshtetes do t'u dergohet Ortakeve me poste, korrier, telecopy ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaku(et) do te marrin vendim per rezoluten perkatese brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe iu eshte dorezuar rezoluta. Ortaku(et) miratojne rezoluten duke I kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te rezolutes me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me rezoluten shprehin me shkrim kundershtite e lyre ne lidhje me rezoluten dhe ia kthejne administratoreve te Shoqerise. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nese aprovohet me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres.

21.6 Secili prej Ortakeve ka te drejten te votoje ne perputhje me kuoten e zoteruar prej tij ne kapital.

21.7 Vendimet e meposhtme do te miratohen me miratimin unanim te Ortakeve :

- (i) Pagesa e çdo dividenti ne kesh apo natyre Ortakeve te Shoqerise;
- (ii) Nenshkrimi i marreveshjeve financiare ne lidhje me Shoqerine apo nxjerrja e instrumenteve te borxhit nga Shoqeria;
- (iii) Blerja e çfareddoljoj kuote apo interes terter ne çdo biznes dhe sipermarrje;
- (iv) Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise siç eshte percaktuar ne Nenin 7 te ketij statutit;
- (v) Ndryshime dhe mendime te ketij Akti Themeli; dhe (vi) Likuidimi apo shperdorja e Shoqerise.

21.8 Atehere kur ligji e kerkon kete, rezolutat e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter publik Shqiptar. Ne rast se keto rezoluta miratohen jashte Republike se Shqiperise, ato duhet ti nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njojen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (d.m.th. duhet ti nenshtrohen procedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).

21.9 Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.

21.10 Administratoret duhet te mbajne procesverbalet e çdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne perputhje me kerkesat e Nenit 90 te Ligjit te Shoqerive Tregtare.



Neni 22

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

22.1 Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:

- (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
- (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
- (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

22.2 Kur ky Ortak eshte i perfaquesuar nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes i sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

Neni 23

ADMINISTRATORI

23.1. Administrator i shoqerise emerohet Z. Viktor Kola, i lindur ne 25.08.1965 ne Midhe, Puke dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr.035928958 dhe numer personal G50825122M.

23.2 Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat **5 vjeçar** me te drejte riperteritje bazuar ne Nenin 95/1 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

23.3 Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte shoqerise.

Neni 24

KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

24.1 Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare; te punoje, te drejtoje dhe te organizoje ne menyre qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko financiare.
 - b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
 - c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
 - q) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve dhe t'i paraqese per miratim tek Asambleja e Pergjithshme.
 - d) te krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
 - dh) te kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
 - e) te raportoje perpara Asamblese ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- 23.2 Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjithe personave fizike e juridike, publike

dhe/ose private vendas apo te huaj, autoritetet shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve.

23.3 Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rr Ethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht Asamblese se shoqerise.

23.4 Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rr Ethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Neni 25

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre Vite financiare, me mundesi rizgjedhjeje. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi, ne rast se kryhen shkelje, verehen gabime ose behet e pamundur kryja e detyres.

Neni 26

VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, Viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e veçanta te hartuara nga Administratori dhe nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga asambleja e ortakeve.

Neni 27

BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

KREU VI

MENYRA DHE KUSHTET E PERDORIMIT TE FITIMIT

Neni 28

Pas perballimit te detyrimeve qe ka shoqeria, taksave, tatimeve, pagave te punonjesve dhc shpenzimeve te tjera, fitimin neto te shoqerise qe i perket ortakeve te saj, mund ta perdonin ata lirish sipas deshires se tyre.

KREU VII

MARRDHENIET E PUNES DHE PERGJEGJESIA

Neni 29

Marrdhieniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me kete Statut dhe Kodin e Punës ne Republikën e Shqipërisë. Shoqeria lidh kontraten per marrjen ne pune te punonjesve te saj ne perputhje me Kodin e punës.

Neni 30

Punonjesi ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen me profesionalizem dhe disipline te punes. Ortaket, administratori dhe punonjesit e shoqerise jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, informacionit, njohurive dhe pervojes se fituar e shkembryer ne kuadrin e shoqerise, fshehtesine e gjendjes financiare dhe burimeve te mallrave, identitetin e shumave te te ardhurave te saj, depozitave si dhe te dhena te tjera per organizimin dhe orientimin e shoqerise qe konsiderohen sekrete te punes. Detyrimi per ruajtjen e sekretit vazhdon edhe pas nederprerjes se marrdheneve te punesimit m eshoqerine.

KREU VIII

MBARIMI I SHOQERISE

Neni 31

PRISHJA E SHOQERISE

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- q) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te Nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";
- d) me vendim te gjykates;

Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Kur shoqeria pushon aktivitetin e saj, pasi shlyen detyrimet qe ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurat i mbeten ortakeve te saj.

Neni 32

TRANSFORMIMI I SHOQERISE

Transformimi i shoqerise behet me vendimin unanim te Asamblese se Pergjithshme ose kur ekzistojne faktore te jashtem detyrues ligjore, ne keto raste vendimi merret pasi i eshte paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqerise nga ana e administratorit.

Çdo transformim i bere ne kundershtim me kete nen eshte i pavlefshem.

Neni 33

Ne rast vdekje te ortakeve, pasuria e tyre i kalon ne pronesi trashegimtareve ligjor ne perputhje me dispozitat ligjore per trashegimine.

IX DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 34

Shoqeria deklarohet e krijuar e vendimin e ortakeve te shoqerise. Nga kjo date fiton statusin e Personit Juridik.

Neni 35

BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil, Ligji "Per Koncesionet" dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 36

MOSMARREVESHJET

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te tentohet te zgjidhen me konsensus dhe mirekuptim.

Ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 37

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Ky Statut u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, me vlore te njejtë juridike.

ORTAKET THEMELUES

Nikoll Kola

Viktor Kola